



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Tiranë, më 23.11.2020

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektorit, datë 23.11.2020 “Mbi shpalljen e konkursit për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **23.11.2020 deri më 27.11.2020**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialiteteve ku aplikon.

I. Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit

Moduli: “SPSS” (Master Shkencor)	1(një) Lektor
Moduli: “Menaxhim- Marketing Sportit” (Bachelor)	1(një) As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Lektor, në modulin: “SPSS” (Master Shkencor), në Departamentin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar studimet e larta.
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojnë sipas departamentit ku aplikon.
- Të ketë së paku gradën “Doktor i Shkencave”
- Të zotërojë njërën nga gjuhët e BE; anglisht, frengjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht me dëshmi.
- Të kete veprimtari shkencore si: referime, botime, studime.
- Preferohen kandidatët qe kanë pervoje pune akademike në mësimdhënie e kërkim shkencor në fushën përkatëse të IAL.
- Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shtetit.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për As/Lektor, në modulin: “Menaxhim-Marketing Sportit” (Bachelor), në Departamentin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar studimet e larta.
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojnë sipas departamentit ku aplikon.
- Të ketë së paku gradën Msc.

- Të zotërojë njërën nga gjuhët e BE; anglisht, frengjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht me dëshmi.
- Të kete veprimtari shkencore si: referime, botime, studime.
- Preferohen kandidatët qe kanë pervoje pune akademike në mësimdhënie e kërkim shkencor në fushën përkatëse të IAL.
- Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shtetit.

I. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shenuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, lëndën ku aplikojnë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✓ Curriculum Vitae (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Bachelor (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- ✓ Certifikatën e gradës “Doktor i Shkencave” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor i Asociuar” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Fotokopje e kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- ✓ Dëshmi penaliteti (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- ✓ Numrin e llogarisë bankare (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Vërtetim nga qendra e punës me lejen për t’u angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë FSHL – UST (nqse është i punësuar)
- ✓ Vertetim nga Dega e Tatim Taksave në rast se është i/e papunësuar .
- ✓ Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

II. Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

III. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.

IV. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron KASA